



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/ Nr. 5071 /2018
Data: 18.06.2018

PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e pestë - V- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 31.05.2018 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Fari Kalisi (Drejtor për Administratë), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Medina Imishti (Drejtoresh për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrotje të Mjedisit), Sevime Laçi (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Bajrush Laç (Shef i Zyrës Ligjore), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Faruk Dermaku (Përfaqësues i OSB-së), Irfan Suma (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se mungon një anëtarë i kuvendit të komunës (z.Mehmet Ballzhi).

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.
3. Miratimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për javën kulturore 2018.
4. Pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi thekson:- përveç këtyre pikave të rendit të punës keni edhe një material shthesë të cilin e kam dërguar, propozim vendimi për rishikim të buxhetit të cilin ekzekutivi e ka përgatitur këtë pikë dhe ndër kohë janë informuar se në këtë vit nuk do të ketë rishikim të buxhetit, andaj propozimi i ekzekutivit është se kjo pikë të hiqet nga rendi i punës. Lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- si ekzekutiv kemi bërë përgatitjet për rishikim të buxhetit por nga ana e Ministrisë së Financave jemi informuar se nuk do të ketë rishikim të buxhetit dhe nëse në ndër kohë dërgohen instrukSIONET nga Ministria atëherë mund ta paraqesim si pikë të rregullt në muajin qershor ose nëse kërkohet me urgjencë e paraqesim në mbledhje të jashtëzakonshme. Në qoftë se nuk do të ketë rishikim janë mundësít tjera me bërë rialokim dhe transfere 15% deri 25% nga Qeveria.

Akif Shkreta thekson:- çfarë arsyet ka dhënë Ministria sepse nga vitet e kaluara në këtë periudhë është bërë rishikimi.

Shabi Rexhallari thekson:- njoftim me shkrim nuk kemi por në bazë telefonatave që kemi pas kanë potencuar që rishikim nuk ka dhe Ministri ju ka thënë të gjithë organizatave buxhetore se nuk ka nevojë me bërë rishikim.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim, nëse nuk ka rendin e punës e hedh në votim, rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 14 anëtarë të kuvendit të komunës).

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 14 anëtarë të kuvendit të komunës).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Informatë mbi mbrojtjen e mjedisit.

Kryesuesi thekson:- lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- kemi hartuar informatën për gjendjen në mjedis e cila përfshinë informacionet për vitin 2017. Jemi munduar më hartuar një informatë edhe pse kjo përfshin një pjesë të vogël të gjendjes së mjedisit për shkak se e dimë situatën mjedisore në Han të Elezit. Në informatë kemi bërë listimin e ndotësve më të mëdhenj të mjedisit dhe kemi paraqitur rezultate e monitorimit të cilësisë së ajrit nga stacioni monitorues i cili është i vendosur të shkolla fillore "Ilaz Thaçi". Kemi marr informata nga stacioni i monitorimit të ajrit që është i vendosur te shkolla fillore "Ilaz Thaçi" dhe nga stacioni për monitorimin e ajrit të kompanisë "Sharrcem" . Janë paraqitur investimet e komunës të cilat ndërlidhen me investimet për çështjen e mjedisit. Janë paraqitur aktivitete e komunës dhe të kompanisë "Sharrcem" për çështje të mjedisit.

Nora Xhoni thekson:- informata për mbrojtjen e mjedisit në letër është paraqitur mirë, mirëpo në realitet nuk më doket se është shumë e saktë. Ka shumë shkaktarë të ndotjes së ambientit por ndotës kryesorë është kompania "Sharrcem" dhe mbetjet e azbestçimentos nëpër lumin Lepenc. Komuna duhet të ndërmerr diçka për shkak se shifrat të cilat janë paraqitur nuk janë të sakta.

Akif Shkreta thekson:- në tabelë shihet se oksidet e sulfurit dhe të azotit janë shumë më të ulëta se sa kufijtë e lejuar të rregullores së Bashkimit Evropian për shkak të përqendrimit të tyre në lëndë djegëse dhe në materie të pa përpunuara, ndërsa këtu potencoher që nga këto matje që janë bërë shënon se është shumë e ulët se sa në kufijtë e lejuar në rregulloret lokale të BE-së dhe i bien që nuk ka ndotje të sulfurit ashtu siç flitet. Nëse vërtetohet se është reale është mirë me i njoftuar qytetarët që mos me u krijuar një far konfuziteti se ka ndotje në Han të Elezit. Shqetësuese janë mbetjet e asbest çimentos të cilat i kemi nëpër shtëpitë dhe oborret tona për shkak se ishte një projekt qeveritarë dhe vetëm i ka shpërfaqë mbetjet e azbestit dhe kanë mbetur rrugëve. Si grup parlamentar në bashkëpunim me kryetarin e komunës e kemi iniciuar këtë edhe në kuvendin e Kosovës nëpërmjet deputeteve me të cilët keni raporte të mira dhe e kanë marrë këtë çështje në mënyrë serioze. Drejtoria përgjegjëse dhe kryetari i komunës duhet të gjejnë mundësi buxhetore për me u eliminuar mbetjet e azbestçimentos për shkak se janë të dëmshme.

Nuriman Kuka thekson:- mbetje ka por me një afat s'mundemi me i bërë këto punë sepse ne vet po i shikojmë se si po kryhen punët në Han të Elezit. Unë mendoj se janë duke u zvogëluar punimet dhe në të ardhmen do të kemi një ambient më të mirë. Kërkoj informacion përfshinë e sportit se deri ku kanë arrit punimet. Është diskutuar shumë se trajtimi i ujërave të zeza do të bëhet në atë pjesën poshtë por deri më tani nuk është bërë asgjë. Duhet të bëhet mbjellja e drunjve nëpër të gjitha vendet ku është e nevojshme në Han të Elezit në mënyrë që të kemi gjelbrim. Është mirë që të shfrytëzohen edhe automjetet e zjarrëfiksëve për pastrimin e qytetit të Hanit të Elezit. Pastrimi duhet të jetë më nivel në Han të Elezit sepse kemi edhe kompani tona që mund t'i angazhojmë.

Teuta Shkreta thekson:- nga këto shifra të cilat janë prezentuar shpresoj që 50% të jetë ashtu. Aparati matës krahas matjes së pluhurit a e përfshin edhe kundërmimin e erës për shkak se kundërmon erë e rëndë.

Mefail Suma thekson:- komiteti për politik e financa nuk është duke e ditur rolin e vetë sepse po rrjedhë se vetëm për mëditje janë shkuar në mbledhje. Komiteti për politik e financa është trup ndihmës i kuvendit të komunës. I lexova diskutimet e mbledhjes së komiteti për politik dhe financa por duhet të del me konkluzë , qëndrime, rekomandime, propozime për kuvendin e komunës. Propozoj që KPF-ja të jep rekomandime se a me miratuar pikën e rendit të punë apo mos me miratuar. Po na përcjellin disa punë prej mandatit në mandat dhe mandej vetëm duke ja lënë fajin dikujt. Ndoshta është e vërtetë që përgjegjësin e ka Ministra për Planifikim Hapësinorë e cila i fillon punët dhe pastaj mbeten në gjysmë, mirëpo unë konsideroj që faj kanë më së shumti drejtoret dhe inspektori për mbrojtje të ambientit. Në momentin që përgatitet raporti duhet të japid ide për me bërë zgjidhje. Në raport është përdorur ndotja e ambientit dhe ndotja e tokës por nuk kisha thënë që toka kontaminohet nga azbesti sepse më tepër kontaminohet prej helmeve të ndryshme. Një dit isha në fshatin Gorancë dhe kam parë një deponi ilegale me mbetje të azbest çimentos por ma karakteristike që më ra në sy ishin disa trupa të shelles dhe disa betona. Kompania e cila është kontraktuar për pastrimin e azbest çimentos nuk është kontraktuar për me i bartur trupat e shelles dhe mbetjet e betonit të cilat i kanë hedhë qytetarët. Shumë pakë diskutohet për me i eliminuar mbetjet e azbestçimentos sepse u përmendën që ka edhe nëpër shtëpitë tona. Pastrimin e mbetjeve të azbest çimentos e kam kërkuar edhe kur isha këshilltarë në asamblenë komunale por prapë tash po e diskutojmë dhe nuk është bërë asgjë. Kërkoi sqarim nga drejtoi se çka kuptohet me PM10 dhe PM 2.5.

Hanumshahe Dibrani thekson:- rruga “Lepenci” dhe rruga “Shkodra” të pajiset me shporta për mbeturina për shkak se shumë është e frekuentuar nga një pjesë e madhe e nxënësve. Komuna duhet të bënë një fushatë sensibilizuese për çështjen e ndotjes së ambientit. Të bëhet ndriçimi publik në rrugën “Naim Frashëri”.

Florim Shkreta thekson:- në informatë që është përcjellë formula ka shumë dhe nuk mundem me i kuptuar të gjitha por PM 10 dhe PM 2.5 janë që shkaktojnë më tepër vdekjen ndër ndotësit në ajrin e ndotur për shkak të aftësisë së tyre për të depërtuar thellë në mushkri dhe në sistemin e qarkullimit të gjakut duke shkaktuar rastin më ekstrem mutacion të përhershëm gjenetik arrest kardiak dhe vdekje të parakohshme. Rezultate të cilat i ka monitoruar matësi i ndotësit i cili është i vendosur te shkolla fillore “Ilaz Thaçi” del se vlera mesatare vjetore e emetimit është $26.86 \mu\text{g}/\text{m}^3$, kurse vlerën mesatare më e lartë (Dhjetor) $48.7 \mu\text{g}/\text{m}^3$. Në bazë të monitorimit të matësit te shkolla fillore del se është tejkaluar kjo sasi e ndotjes sepse sipas udhëzimit administrativ del se mbi njëzet mikrometër nuk mund të tejkalojet numri i kësaj shifre dhe paramandoni po të ishte i vendosur matësi me ndonjë vend tjetër që do të thotë se do të shumëfishohej ndotja e ambientit. Grimcat PM 2.5 vlera mesatare vjetore e emetimit është $17.83 \mu\text{g}/\text{m}^3$ në bazë të matësit të ndotjes që është i vendosur te shkolla fillore, kurse më e larta është $39.3 \mu\text{g}/\text{m}^3$ që do të thotë se kjo shifër është tejkaluar dhe sipas udhëzimit administrative nuk duhet të jetë mbi dhjetë mikrometra. Kjo është shqetësim për komunën tonë.

Nexhmedin Daci thekson:- për mendimin tim stacioni për monitorimin e ajrit nuk është i mirë. Dy herë në muaj agjencioni për mbrojtjen e mjedisit i merr rezultatet e matjes dhe i merr me uesbi që do të thotë se rezultate e ndotjes nuk i kemi në kohë reale sepse mund të ndodhë ndotje te PM 10 dhe PM 2.5 por ne nuk e dimë. Pasi dy jave që i marrin rezultatet i përpunojnë dhe kur t'i publikojnë faktikisht nuk ka kurrrafë vlere. Stacioni për monitorimin e ajrit nuk ka qenë funksional gjatë gjithë kohës dhe grimcat PM10 dhe PM2.5 tre muaj radhazi nuk janë mat. Auditori i përgjithshëm vitin e kaluar ka bërë një auditim për stacionet e monitorimit të ajrit dhe ka gjet gabime , mirëpo ai auditim ende nuk është bërë publik. Stacioni për monitorimin e ajrit nuk është i vendosur në vend të përshtatshëm sepse nuk bënë matje reale të ndotjes së ajrit në Han të Elezit. Rregulloret e ndalojnë që stacioni i monitorimit me qenë afér kompanisë “Sharrcem” për shkak se i matë vetëm ndikimet e “Sharrcemit” e jo edhe ndotjet e tjera. Sa i përket azbestçiemntos Ministria e Planifikimit Hapësinorë par tri viteve ka ndërmarr një aksion dhe ai aksion për mendimin tonë ka dështuar dhe komuna vazhdimi shët e ka kundërshtuar. Kompania është larguar prej obligimeve të cilat i ka pas me kontratë , kurse një pjesë të azbestit e kanë vorros në pjesën e Gorancës dhe ndoshta ka mundësi që ndonjë pjesë ka mbet në sipërsfaqe. Për çështje të azbestit me sa jam në dioni janë duke u marr edhe krimet ekonomike. Kryetari ka biseduar me Ministrin dhe kanë potencuar që do të ndërmarrin diçka në këtë drejtim. Nëse Ministria nuk ndërmerr diçka atëherë komunës i mbetet që të bënë një projekt të veçantë për heqjen e mbetjeve të azbestçimentos. Sa i përket erës së rëndë që kundërmon kompania “Sharrcem” përdorë thëngjill për djegieje dhe ai përmban elementet të sulfurit dhe është e dëmshme. Kompania “Sharrcem” nuk e bënë matjen e grimcave PM10 dhe PM2.5 dhe në biseda që kam pas me inspektorët nga Ministria e mjedisit kanë potencuar

se do ta padisin kompaninë "Sharrcem" pér shkak se eshtë e obliguar me ligj me i bërë matjet e këtyre grimcave. Ndotja e ajrit eshtë kompetencë e Ministrisë dhe komuna ka pér detyrë ta njofton Ministrinë përkatëse apo qytetarët me bërë protestë pér shkak ndotjes së ajrit. Me datë pesë qershor eshtë dita e pastrimit dhe brenda mundësive që i kemi do të bëjmë pastrimin e deponive ilegale.

Florim Shkreta thekson:- problemet nuk janë të vogla sa i përket shifrave të cilët janë paraqit. Oksidet e sulfurit dhe oksidet e azotit matësi i cili eshtë i vendosur te shkolla fillore "Ilaz Thaçi" nuk i mat dhe grimcat PM10 dhe PM 2.5 por edhe kompania "Sharrcem" nuk i matë dhe si janë kombinuar.

Nexhmedin Daci thekson:- nuk eshtë kombinim por këto stacione i masin këto parametra kurse tjerat jo. Kompania "Sharrcem" eshtë e obligime me ligj pér me bërë matjen e grimcave PM10 dhe PM 2.5 ajo e matë por nuk e publikon por e mbanë pér raport të vetin.

Florim Shkreta thekson:- kërkoi që matësi i cili eshtë i vendosur te shkolla fillore "Ilaz Thaçi" t'i ndërrohet vendi dhe të vendoset një matës i cili tërë kohën e monitoron ajrin.

Nexhmedin Daci thekson:- sa i përket matësit edhe unë pajtohem dhe si komunë do ta kërkojmë, mirëpo këto çështje janë në kompetencë të Ministrisë së Planifikimit Hapësinorë.

Menduh Vlashi thekson:- fusha e futbollit eshtë dëmtuar pér shkak të projektit të pastrimit të asbestçimentos dhe kontrata eshtë ndërprerë me atë kompaninë . Kryetari i komunës në javën e kaluar ishte në takim me kryetarin e federatës së futbollit, me përfaqësuesit e kompanisë "Sharrcem" dhe kanë potencuar që do ta rregullojnë. Sa i përket mbjelljes së drunjve duhet të bëhen projekti aty ku eshtë e nevojshme i mbjellim drunjët por duhet të planifikohen në buxhetin pér vitin 2019.

Nexhmedin Daci thekson:- nuk ka efekt nëse investojmë në ujërat e zeza sepse lumi Lepenc vjen i ndotur. Është diskutuar shumë vite që Ferizaji, Kaçaniku dhe Hani i Elezit me u përfshirë me një impiant por me sa jam i njoftuar eshtë pak problem hapësira.

Florim Shkreta thekson:- në informatë janë shënuar investimet publike të komunës që kanë të bëjnë me mjedisin dhe eshtë potencuar rregullimi i prrocës dhe kanalizimit fekale në fshatin Seçishtë , mirëpo si eshtë paraparë në projekti me u realizuar.

Nexhmedin Daci thekson:- në projekt ka qenë me u realizuar në mënyrë të hapur po ka individë të cilët kërkojnë me u mbyllur pér shkak se disa banorë janë duke e bërë rrafshimin e pronave. Ka disa banorë të cilët nuk kanë prona pér rrëth dhe kërkojnë që projekti të realizohet në mënyrë të hapur. Komuna nuk mundet me i imponuar kërkuesat e qytetarëve.

Florim Shkreta thekson:- sa i përket banorëve edhe pse jam administratorë i fshatit nuk kam kur far interesit se a do të jetë i hapur apo i mbyllur projekti, mirëpo në takim që kemi pas me ish drejtorin z.Miqail Vila eshtë paraparë se si do të jetë përrroi nga shtëpia e z.Emrush Kuka deri mbi fshatë me qenë i mbyllur . Unë kam kërkuar që projekti me u realizuar sikur se në lagje të re pér shkak se eshtë problem prej dy ujërave në dy anët dhe mund të ketë probleme , mirëpo nuk ka pas buxhet dhe jam dakorduar. Unë kam kërkuar që të jetë një far lloj korite por banorët kanë kërkuar që të jetë i mbuluar deri te varrezat dhe nga varrezat e deri nën breg banorët kanë kruar që të jetë i hapur. Në projekt eshtë i hapur dhe potencon që eshtë i dyshimtë dhe ndoshta duhet të mbylljet por duhet të dalin gjërat në shesh dhe të tregohet një realitet. Unë jam administratorë i fshatit dñe nga momenti që do të shkarkohem unë eshtë mirë me i bërë këto gjëra sepse si administratorë nuk mundem me kontribuar deri te një telashe apo deri të një problem pér shkak se dihet pér kënd eshtë fjalë pér dy fshatarë sinqertë. Banorët kanë kërkuar që të jetë i hapur dhe ju mund ta realizoni projektin e mbyllur po me pëlqimin tim jo sepse nuk mund të hy në këto lojëra pér shkak se janë banorë të fshatit tim, kurse banorët të cilët kanë kërkuar që të jetë i mbyllur gjoja se nuk paskan rrugë unë ju bëjë zgjidhje. Duhet të dihet se problemi eshtë te

gurëthyesi atje lartë dhe kryetari duhet me i trajtuar njëjtë qytetarët dhe kompanitë për shkak se asnjë herë nuk ka kërkuar nga unë si administratorë i fshatit me bërë zgjidhje por edhe tenderi kur është anuluar më herët është anuluar krejt për disa gjëra tjera e jo për atë se çka bisedohet.

Akif Shkreta thekson:- realisht me fol më mirë do të ishte që projekti me qenë i mbyllur sepse shfrytëzohet për këmbësorë, apo çiklizëm e jo për kamionë sepse për kamionë kemi dhënë një propozim që me i zhvendosur në pjesën tjetër dhe do të ishte shumë më mirë me qenë i mbyllur.

Florim Shkreta thekson:- nuk mendoj siç parashihet se ka me funksionuar prrocka e mbyllur dhe për këmbësorë ka me pas trotuar. Ankesë kam pas nga banorët të cilët jetojë aty për mos me qenë i mbyllur sepse në takime që kemi pas jemi dakorduar me qenë i hapur kurse tash paraqesin ankesa pse me qenë i mbyllur dhe për gjërat të cilat bëhen në mënyra tjera nuk jam i informuar. Nëse përrroca do të mbyllët probleme do të ketë për ato banorë të cilët jetojnë në atë pjesë.

Rufki Suma thekson:- çështja e prrockës është biseduar dy apo tri herë sepse është shpallur tenderi dhe është anuluar tenderi dhe parafolësi e dinë shumë mirë që nuk është bërë për ndonjë çështje tjetër por me kërkesën tende. Nëse pyeten të gjithë qytetarët është problem për me u dakorduar por duhet të merret mendimi i shumicës. Pjesa nga varrezat deri te kukët jemi dakorduar të gjithë që me qenë i mbyllur, mirëpo banorët e lagjes së kukëve kanë bërë kërkesë me dymbëdhjetë nënshkrime të cilët kanë kërkuar që me qenë i hapur por punimet duhet të vazhdohen sipas projektit. Nga burimi deri te varrezat është i hapur dhe ka probleme nga banorët të cilët potencojnë se pse nuk ma rregulloni urën që komuna nuk i ka ndërtuar askujt dhe vetëm nëse vlerësohet se është e domosdoshme duhet t'i shikojmë gjatë ekzekutimit të punimeve. Pjesa tjetër nga Burimi deri në lumin Lepenc është i hapur i projektuar dhe për komunën dhe punë kryesin është më lehtë me bërë realizimin e punimeve, mirëpo ka ndryshuar gjendja faktike për shkak të rrafshimit të pronave dhe është problem lëvizja e banorëve nëpër pronat e tyre dhe nuk bëhet për interes të askujt.

Florim Shkreta thekson:- sa i përket nënshkrimeve të lagjes së kukëve unë mund ta rregullojë atë çështje sepse dikush nuk vjen në mbledhje dhe pastaj jep sugjerime në forma të ndryshme. Unë mendoj që punët duhet të kryhen në bazë të projektit sepse banorët të cilët kanë prona në atë pjesë nuk munden me mbetur pa rrugë për shkak se rruga është përmes urës e cila është në funksion.

Teuta Shkreta thekson:- nëse realizohet projekti në mënyrë të hapur mendoj që duhet të bëhen investime shumë të mëdha sepse fshati nuk i ka të gjitha të rregulluara dhe nuk mund të merret vetëm me rregullimin e asaj prrocke, mirëpo neve na duhet një stazë për biciklista apo për këmbësorë, gjelbërim dhe drunj dekorativ.

Sabedin Hasallari thekson:- drejtoria e shëndetësisë a ka ndonjë raport të saktë për personat të cilët kanë vdekur pas lufte dhe nëse nuk keni informacion mund ta dërgoni në ndonjë mbledhje të radhës sepse nëse është një numër i madh i personave është mirë që institucionet komunale me kërkuar dëmshpërblim prej shtetit tonë për shkak se shihet se fabrikën e azbestit pushteti i atëhershëm qëllimisht e ka ndërtuar në Han të Elezit. Komuna e Obiliqit po përfiton mjete financiare si komunë më e ndotur andaj kërkoj që edhe komuna jonë të kërkon dëmshpërblim për personat të cilët kanë vdekur nga kanceri dhe ata të cilët janë të sëmurë prej kancerit.

Medina Imishti thekson:- për momentin nuk e kam ndonjë shifër të saktë por sëmundjet me kancer, rastet janë më shumë të punëtorëve të cilët kanë ndërruar jetë dhe po besojmë prej ndikimit të fabrikës. Nga Ministria është një projekt për ndotje të ambientit dhe për vdekshmërinë e madhe që po ndodhë por nuk i di arsyes se pse komuna e Hanit të Elezit nuk është përfshirë, mirëpo do të parashtrojë kërkesë që edhe Hani i Elezit me qenë pjesë e atij projekti.

Mefail Suma thekson:- në fabrikën e azbesti kam qenë referent dhe nga data 01.01.1975 deri në vitin 2010 i ofrohet numrit 1000 lëvizja e punëtorëve të cilët kanë qenë të regjistruar. Vdekja e parë që ka qenë ishte Refik Loku dhe numri i punëtorëve që kanë vdekur është kogja i madh. Edhe pas mbylljes ka raste të vdekjes së punëtorëve edhe të komunës së Kaçanikut edhe të Hanit të Elezit që do të thotë se kjo sëmundje është evidente. Nga AKP-ja janë lëshuar disa vendime për dëm shpërblim dhe në vendim potencohet se asbestoza qenka

sëmundje e fshehtë sepse gati çdo punëtorë e paska dhe në bazë të analizave apo kontrolleve nuk mundet me u zbuluar po në momentin që ja nisë me vepruar brenda tre muaje shkakton vdekjen. Kohët e fundit kolegët e mi që i kam njohu kanë ndërruar jetë prej azbestit dhe QKMF-ja nuk e di a ka numër të saktë. Është mirë të bëhet një analizë për këtë çështje dhe të dalim me një rezultat të vdekjes së njerëzve.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës së rendit të punës.

3. Miratimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për javën kulturore 2018.

Kryesuesi thekson:- lidhur me rendin e punës hapi diskutimin.

Menduh Vlashi thekson:- java kulturore është bërë tradicionale sepse nga momenti që jemi bërë komunë e kemi mbajt javën kulturore. Çdo vit është bërë kërkesë në kuvendin e komunës për mbështetje financiare dhe mjetet financiare do të merren nga mallrat dhe shërbimet. Kërkoj nga këshilltarët që të miratohet propozim vendimi.

Mefail Suma thekson:- java kulturore a përfshinë vetëm sportin apo edhe diçka tjetër.

Nuriman Kuka thekson:- e përkrahi propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare sepse ka nevojë që të shpërblehen sportistët dhe besoj që java kulturore do të shkon mirë.

Nora Xhoni thekson:- për shkak të punimeve që janë duke u zhvilluar në magjistrale, a është caktuar lokacioni se ku do të mbahet krosi.

Menduh Vlashi thekson:- është javë kulturore por aktivitet ja njëmbëdhjetë ditë dhe krahas sportit do të mbahet edhe manifestimi për nderë të ditës së çlirimit, ora poetike. Sa i përket caktimit të vendit për krosin ende nuk jemi përcaktuar por do të takohemi me këshillin organizativë dhe do të vendosim por po mendojmë që krosin me mbajt në pjesën e magjistrales ka Uji i Thartë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin 13 anëtarë të kuvendit të komunës).

U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E MJETEVE FINACIARE PËR JAVËN KULTURORE.

4. Pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Besarat Suma thekson:- përpos ajrit si dukuri parësore edhe siguria në rrugë është shqetësim për ne duke e marr parasysh qarkullimin e dendur të automjeteve në magjistralen Prishtinë - Hani i Elezit dhe sidomos punimet e kompanisë "Bektelenka" qarkullimi i automjeteve të rënda ka bërë që siguria në rrugë të jetë shumë e rrezikshme për këmbësorët. Në qendër të qytetit nuk ka të vendosur vija të bardha për me kaluar këmbësorët që është shumë e rrezikshme për qytetarët e sidomos për fëmijët të cilët udhëtojnë për çdo ditë në shkollë. Kjo çështje duhet të bëhet në mënyrë urgjente sa nuk ka ndodhë ndonjë fatkeqësi sepse nëse ndodhë edhe nëse merren masa urgjente do të jetë vonë.

Mefail Suma thekson:- kërkoj që asambleja komunale të shkon dhe ta viziton kompaninë në fshatin Gorancë të cilës i kemi dhënë pëlqim për fillimin e punimeve. Është mirë që me bërë një organizmi për asamblenë komunal udhëtim dy ditorë në Shqipëri. Kërkoj që edhe komuna të organizon iftar për anëtarët e asamblesë komunale.

Akif Shkreta thekson:- rruga për gjatë hekurudhës që është duke i zhvilluar punimet kompania “Bektelenka” banorët kanë kërkuar që për gjatë hekurudhës deri te pronat bujqësore me u bërë një rrugë për bujqit në atë pjesë. Propozoj që mësimi mos me u mbajt në këtë të shtune për shkollën filllore ‘Ilaz Thaçi’ sepse i kemi dy shëtitje në natyrë të cilat nuk i kemi shfrytëzuar.

Teuta Shkreta thekson:- krahas që është rreziku për këmbësorë por rreziku është edhe i veturave dhe është mirë që policia të del në rrugë sepse ka tri apo katër muaj që polica nuk ka dal në rrugë.

Florim Shkreta thekson:- kam parashtruar pyetje dhe më janë vonuar dy muaj në dhënien e përgjigjeve dhe mi kanë dërguar aty për aty në mbledhje të kuvendit të komunës. Kam parashtruar pyetje se për çfarë arsyë më fshihen komentet në adresë të komunës së Hanit të Elezit dhe më është dhënë përgjigja se për të informuar për aktivitete e komunës dhe në këtë faqe nuk lejohen komentet fyese. Për përgjigjen që është dhënë nuk jam fare i kënaqur se nuk qëndron këtu problemi sepse asnjë herë nuk kam fyer dikendë por kam kërkuar ndonjë informacion në këtë adresë dhe komenti më është fshirë. Kam komentuar përsëri pa kur far fyerje dhe komenti më është fshirë. Nuk jam person i vetmi që më janë fshirë komentet dhe ka edhe shumë qytetarë të cilët janë ankuar në këtë drejtim. Kemi edhe komentin e qytetarit nga Hani i Elezit z. Reshat Osmani i cili komenton pa e fyer askënd dhe vetëm paralajmëron një rrezik të mundshëm që mundet me ndodhë dhe i fshihet komenti. Kjo tregon se në këtë komunë nuk ka transparencë dhe qytetarit i mohohet e drejta për me shprehur mendimin e tij që do të thotë se ka diktaturë. Përsëri kërkoj përgjigje me shkrimë. Kam kërkuar informacion nga kryetari i komunës për vizitën e 28 nëntorit në Shqipëri dhe përgjigja më është dhënë se ekzekutivi i komunës ka marr pjesë në Shqipëri në manifestimin qendrorë të Tiranës të mbajtur me 28 nëntor për nderë të ditës së flamurit dhe shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Unë nuk e kuptojë se çfarë përgjigje është kjo. Pyetje radhës ishte se a ka qenë zyrtarisht, me këndë jeni takuar në Shqipëri dhe kush ka marr pjesë dhe përgjigja më është dhënë se vizita ka qenë zyrtare dhe ka marr pjesë ekzekutivi i komunës dhe kryesuesi i kuvendit të komunës. Edhe me këtë përgjigje nuk jam i kënaqur dhe kërkoj përgjigje përsëri dhe të bashkëngjitet ftesa zyrtare dhe agjendën me kënd jeni takuar për shkak se keni marr mëditje dhe keni shpenzuar paranë publike. Vlen të theksohet se gjatë këtij udhëtimi zyrtarë ju keni takuar edhe pronarin e kompanisë “Luri” dhe drejtorin e shërbimeve publike në një hotel tjetër. Nuk më pengon se pse keni pas takime me pronarin e kompanisë “Luri” por më interesojnë mëditjet të cilat i keni marr. Pyetjen tjetër të cilën e kam parashtruar kam kërkuar informacion nga kryesues i kuvendit për vizitën në Shqipëri për datën 28 nëntor i vetëm si kryesues sepse ka qenë e planifikuar që si kuvend të shkojmë bashkërisht. Përgjigja më është dhënë se kryesuesi i kuvendit të komunës rregullisht merr pjesë në takimet e ekzekutivit dhe në momentin që ekzekutivi mori vendim për vizitën e 28 nëntorit në Shqipëri mori pjesë si kryesues sepse kuvendi ishte shpërbërë për shkak të shpalljes së zgjedhjeve lokale. Nuk jam i kënaqur me këtë përgjigje për shkak se kuvendi i komunës nuk shpërbëhet deri në formimin e kuvendit të rrij dhe përsëri kërkoj përgjigje me shkrim ashtu siç ka qenë rasti e jo të thuhet se zyrtarisht ishim në shesh sepse edhe unë kam qenë por isha me mjete financiare të mbiat. Pyetja e radhës ishte Informacion për pedagogun z.Irfan Qajani sa muaj ka qëndruar drejtorë pasi është zgjedhur pedagog. Në përgjigje keni potencuar se i lartë shënuari ka udhëhequr drejtorinë deri në fund të mandatit dhe kërkoj që të më sqarohet me shkrim për pedagogun z.Irfan Qajani vendimin se kur është pranuar si pedagog dhe sa ka vazhduar të ushtroj detyrën e tij si drejtorë.

Kryesuesi thekson:- vitin e kaluar kemi pas të planifikuar si kuvend me shkuan në Shqipëri, mirëpo problemi është shfaqur në muajin e gjashtë se rishikim të buxhetit nuk ka bërë Qeveria dhe nuk kemi pas mundësi me i ekzekutuar mjetet financiare dhe për atë arsyë si kuvend nuk kemi mundur me shfrytëzuar. Si kryesues kuvendi çdo herë kur të organizon ekzekutivi takime unë do të marr pjesë. Për vizitë në kompaninë e cila është duke i zhvilluar punimet në fshatin Gorancë mund të shkojmë nuk është problem por edhe në Shqipëri do t'i shkojmë mundësit me shkuan. Për çështje të iftarit ndoshta ekzekutivi për nderë të ditës së çlirimt do të organizon iftar dhe besoj që asambleja komunale do të jetë e ftuar.

Nuriman Kuka thekson:- kërkesë kam nga të rinjtë e Hanit të Elezit për çështjen stadiumit të futbollit.

Sabedin Hasallari thekson:- kalimi i automjeteve për mes rrugës Hani i Elezit –Gorancë për shkak të mbylljes së magjistralës Hani i Elezit - Prishtinë ka shkaktuar dëme të pusetave të kanalizimit dhe trotuaret në fshatin Gorancë . A keni biseduar me Ministrinë e Infrastrukturës për sanimin e këtyre dëmeve sepse përmes mjeteve të informimit kanë premtuar që kanë me i rregullouar dëmet.


Rufki Suma thekson:- është bërë problem çështja e sigurisë në komunikacion por për çdo vit kemi bërë zebroat por janë dëmtuar për shkak të punimeve dhe në momentin që do të përfundojnë punimet do të bisedojmë me kompaniën “Bektelenka” për me i bërë zebroat. Për çështjen e hapjes së rrugës për gjatë hekurudhës për pronat bujqësore do të shikohen mundësit dhe mund të rregullohet ajo rrugë. Sa i përket z. Florim Shkreta nuk patë pyetje konkrete por patë komente të pyetjeve dhe përgjigjeve sepse përgjigjet kur ipen nuk ipen për qeft të këshilltarit se a i shkon për shtati apo nuk i shkon por i japim si përgjigje. Nëse kërkon edhe dhjetë herë do t'i keni këto përgjigje dhe nuk do të keni tjera. Çështja e shkuarjes në Shqipëri edhe këshilltarët edhe arsimtarët i sportit në çdo takim e kemi biseduar dhe ishim edhe te federata e futbollit por problemi është se Ministria e ka projektin dhe nuk ka hequr dorë sepse Ministria e Mjedisit ka bërë padi kundër punë kryesit për punët të cilat i ka lënë në gjysmë. Shporta për mbeturina mund të vendosim ku do që është e nevojshme , mirëpo ka raste që i kemi vendosë dhe qytetarët i kanë hedh mbeturinat e tyre në ato shporta duke e shfrytëzuar rastin për mos me paguar. Të gjithë e dimë që rruga e Gorancës është dëmtuar dhe nuk janë zbatuar vendimet e Qeverisë që mos me i lejuar kamionët të cilët janë me peshë të madhe. Ministria ka premtuar përmes medieve por konkretë nuk ka diçka dhe përmes zyrtarit të shërbimeve publike janë identifikuar dëmtimet e pusetave dhe brenda mundësive buxhetore do t'i rregullojmë.

Florim Shkreta thekson:- kryetari po bëhet nervozë por mu më vyen argumentet pra ftesa zyrtare sepse nuk është reale me potencuar se ishim me ftesë zyrtare në shesh në Tiranë.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë rendit të punës, nëse nuk ka ju faleminderit në pjesëmarrje

Mbledhja përfundoi në ora 12:49.

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit
MSc. Qamush Brava